



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.4

17 janar

2007

P Ë R M B A J T J A

Ligj nr.9678
datë 13.1.2007

Për dhënie amnistie.....

Faqe

67

LIGJ
Nr. 9678, datë 13.1.2007

PËR DHËNIE AMNISTIE

Në mbështetje të neneve 81 pikat 1 e 2 shkronja “ë” dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

1. Amnistohen personat e dënuar me burgim deri në 2 vjet, personat e dënuar sipas kreut VII “PJESA E PËRGJITHSHME” të Kodit Penal (alternativat e dënimit me burgim), personat e dënuar me gjobë, si dhe personat e dënuar me burgim ose dënime më të lehta, të cilëve, në datën 31 dhjetor 2006, u kanë mbetur, pa vuajtur nga ky dënim, deri në 2 vjet, me përjashtim të parashikimeve të nenit 3 të këtij ligji.

2. Amnistohen të dënuarat femra, që në datën 31 dhjetor 2006 kanë qenë baraz ose mbi moshën 55 vjeç dhe meshkujt, që kanë qenë baraz ose mbi moshën 60 vjeç, me përjashtim të parashikimeve të nenit 3 të këtij ligji.

3. U zbritet 1/4 (përsëritësve të së njëjtës vepër penale u zbriten 1/8) e dënimit të mbetur të gjithë të dënuarve, të cilët nuk përfitojnë nga pikat 1 dhe 2 të këtij neni, me përjashtim të parashikimeve të nenit 3 të këtij ligji.

Neni 2

Pavarësisht nga parashikimet e nenit 3 të këtij ligji, amnistohen të dënuarit me burgim, të cilët, në kohën e kryerjes së veprës penale, kanë qenë baraz ose nën moshën 18 vjeç, me përjashtim të atyre, që janë dënuar për vepra penale, të parashikuara në nenet 77, 78, 79 e 101 të Kodit Penal.

Neni 3

Nuk përfitojnë nga kjo amnisti personat e dënuar për:

a) vepra penale, të parashikuara në nenet 76 (vrasje me dashje), 77 (vrasje me dashje, në lidhje me një krim tjetër), 78 (vrasje me paramendim) dhe 79 (vrasje në rrethana të tjera cilësuese) të Kodit Penal dhe vrasje e mbetur në tentativë, si dhe neni 77 i Kodit Penal Ushtarak;

b) vepra penale, të parashikuara në nenet 100 (marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur), 101 (marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës 14-18 vjeç), 102 (marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura), 102/a (marrëdhënie homoseksuale me dhunë me të rritur), 103 (marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona të pazotë për t'u mbrojtur), 104 (marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me kërcënim, me përdorimin e armës), 106 (marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari) dhe 108 (vepra të turpshme) të Kodit Penal;

c) vepra penale, të parashikuara në nenet 109 (rrëmbimi ose mbajtja peng e personit) dhe 109/b paragrafi i dytë dhe i tretë (shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës, për dhënien e pasurisë) të Kodit Penal;

ç) vepra penale, të parashikuara në nenet 110 (heqja e paligjshme e lirisë), 110/a (trafikimi i personave), 111 (rrethimi i avionëve, anijeve dhe mjeteve të tjera), 114 (shfrytëzimi i prostitucionit), 114/a (shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese), 114/b (trafikimi i femrave), 128/a (fshehja ose ndërrimi me dashje i fëmijës) dhe 128/b (trafikimi i të miturve) të Kodit Penal;

d) vepra penale, të parashikuara në nenet 135 (vjedhja e kryer, duke shpërdoruar detyrën), 136 (vjedhja e bankave dhe arkave të kursimit), 138 (vjedhja e veprave të artit e kulturës), 138/a (trafikimi i veprave të artit dhe kulturës), 139 (vjedhja me dhunë), 140 (vjedhja me armë), 141 (vjedhja me pasojë vdekjen), 141/a (trafikimi i mjeteve motorike), 143/a (skemat mashtruese dhe piramidale), 152 paragrafi i tretë (shkatërrimi i pronës me eksploziv) të Kodit Penal, si dhe për (vjedhje të pronës ushtarake, me pasojë vdekjen), e parashikuar në nenin 59 pika 2 të Kodit Penal Ushtarak;

dh) gjenocid, krime kundër njerëzimit dhe krimet e luftës, të parashikuara në nenet 73, 74 e 75 të Kodit Penal;

e) vepra penale, të parashikuara në nenet 86 (tortura), 87 (tortura me pasoja të rënda) dhe 89/a të Kodit Penal;

ë) krime kundër pavarësisë dhe integritetit, të parashikuara në nenet 208, 209, 210, 211, 212, 213, 214, 215, 216, 217 e 218 të Kodit Penal;

f) krime kundër rendit kushtetues, të parashikuara në nenet 219, 220, 221, 222, 223, 224 e 225 të Kodit Penal;

g) krime, që cenojnë marrëdhëniet me shtetet e tjera, të parashikuara në nenet 226, 227, 228 e 229 të Kodit Penal;

gj) akte terroriste, të parashikuara në nenet 230, 230/a, 230/b, 230/c, 230/ç, 231, 232, 233, 234, 234/a e 234/b të Kodit Penal;

h) vepra penale, të parashikuara në nenet 248 (shpërdorimi i detyrës), 259 (korrupsioni pasiv i personave, që ushtrojnë funksione publike) dhe 260 (korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë) të Kodit Penal;

i) vepra penale, të parashikuara në nenet 278 paragrafi i parë dhe i katërt (prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit) dhe 278/a (trafikimi i armëve dhe i municionit) të Kodit Penal;

j) vepra penale, të parashikuara në nenet 282/a (trafikimi i lëndëve plasëse, djegëse, helmuese dhe radioaktive), 283 (prodhimi dhe shitja e narkotikëve), 283/a (trafikimi i narkotikëve), 283/b (krijimi i lehtësive për marrjen dhe përdorimin e drogës), 284 (kultivimi i bimëve narkotike), 284/a (organizimi dhe drejtimi i organizatave kriminale), 284/c (prodhimi dhe fabrikimi i lëndëve narkotike dhe psikotrope), 284/ç (prodhimi, tregtimi dhe përdorimi i paligjshëm i prekursorëve), 286 (nxitja për përdorimin e drogës), 287 (pastrimi i produkteve të veprës penale), 287/a (çelja e llogarive anonime), 288 (prodhimi dhe shitja e ushqimeve dhe e lëndëve të tjera të rrezikshme për shëndetin) e 298 (ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit) të Kodit Penal;

k) vepra penale, të parashikuara në nenet 270 (rebelimi i të burgosurve), 333 (organizata kriminale), 333/a (grupi i strukturuar kriminal) dhe 334 (kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal) të Kodit Penal;

l) vepra penale, të parashikuara në nenet 319 (korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë) e 319/a (korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë) të Kodit Penal.

Neni 4

Për efekt të zbatimit të këtij ligji, quhen të dënuar:

a) personat e dënuar nga gjykata e shkallës së parë që, brenda afatit ligjor, nuk kanë bërë ankim ose apel në gjykatën e apelit;

b) personat e dënuar nga gjykata e apelit.

Neni 5

Pushohen ndjekjet penale për çështjet në hetim, për çështjet e pashqyrtuara nga gjykatat, si dhe për kallëzimet, që ndodhen në këto organe dhe në organet e rendit publik, për veprat penale të kryera deri në datën 31 dhjetor 2006, për të cilat Kodi Penal parashikon një dënim me burgim deri në 2 vjet ose çdo lloj dënimi tjetër më të lehtë.

Neni 6

Ngarkohen Ministri i Drejtësisë, Ministri i Brendshëm, Ministri i Mbrojtjes dhe Prokurori i Përgjithshëm për zbatimin e këtij ligji.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5195, datë 16.1.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi Zhan d'Ark, prapa ish-Ekspozitës "Shqipëria Sot", Tel: 042 555 63; ose 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. **KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
2. **KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
3. **REGJISTRAT E NOTERISË**
4. **PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:**
 1. **PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006) 1500**
 2. **PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005) 600**
 3. **PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006)..... 1300**
 4. **PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT..... 500**

BOTIME TË REJA

1. **TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I)..... 1000**
2. **TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)..... 500**
3. **TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I)..... 1000**
4. **TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)..... 500**
5. **PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË..... 1000**
6. **PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR..... 800**
7. **PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET..... 500**
8. **PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006)..... 1000**
9. **PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE..... 500**

Hyri në shtyp më 17.1.2007
Doli nga shtypi më 17.1.2007

Tirazhi: 3500 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja Grafon
Tiranë, 2007

Çmimi: 8 lekë